

Mirëdita,

Sot, Bordi i Arsimit shpalli 3 finalistët që konsiderohen të shërbejnë si Superintendent i ardhshëm i Drejtorisë Arsimore të Filadelfias. Ata janë:

- John L. Davis Jr., Shefi i Shkollave, Shkollat Publike të Qytetit Baltimore,
- Krish Mohip, Zëvendës Zyrtari Arsimor, Bordi i Arsimit i Shtetit të Illinois,
- Tony B. Watlington Sr., Ed.D., Superintendent, Shkollat Rowan-Salisbury

Ju mund të lexoni biografinë e tyre të plotë në philasd.org/schoolboard/search.

Siç u njoftuat [dje](#), nga e [Hëna, 14 Mars](#) - e [Mërkurë, 16 Mars](#), çdo finalist do të kalojë një ditë këtu në Filadelfia për të marrë pjesë në takime dhe ngjarje publike me anëtarët kryesorë të komunitetit, duke përfshirë takime në - person dhe të transmetuara drejtpërdrejtë me studentë, mësues, drejtorë, prindërit dhe kujdestarët. **Ju ftoj të vizitoni philasd.org/schoolboard/search për të parë orarin e plotë.**

Vizita e secilit finalist do të bëhet në menyre individuale publike në “town hall” nga ora 6-7 pasdite në godinën e North Broad Street të Drejtorisë Arsimore, e moderuar nga reporterja WHYI Cherri Gregg. Për të siguruar aksesueshmërinë, “town hall” do të transmetohet drejtpërdrejt përmes Facebook-ut dhe faqes së internetit të Drejtorisë Arsimore. Shërbimet e përkthimit të gjuhës do të jenë të disponueshme sipas kërkesës. Një përkthyes ASL do të jetë gjithashtu i pranishëm. Si pjesë e angazhimit të Bordit për të siguruar që të pranishmit virtual dhe ata në - person të kenë një përvojë domethënëse në “town hall”, të gjithë pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të sugjerojnë një pyetje për finalistët. Sipas udhëzimeve të përditësuara të Drejtorisë Arsimore të Filadelfisë për COVID-19, maskat janë opsionale dhe nuk kërkohen. [Regjistrimi kërkohet](#) për pjesëmarrjen në - person dhe ulet kush vjen në fillim. Nuk kërkohet regjistrim për të parë në internet.

Shpresoj se do të na bashkoheni virtualisht ose në – person javën e ardhshme.

Sinqerisht,

Leticia Egea-Hinton
Nënkryetare e Bordit të Arsimit
e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias

(Albanian)